

## Kontributi i EC-it për Raportin e KE-së për Kosovën

*Shtator 2017, Prizren*

### PËRMBAJTJE

I. Përmbledhja ekzekutive .....	2
II. Situata ekzistuese në trashëgiminë kulturore në Kosovë.....	3
III. Qendra Historike e Prizrenit me statistika të dhimbshme.....	5
IV. Sfidat në Planifikimin Hapësinor.....	6
V. Aktivizmi qytetar dhe trashëgimia kulturore.....	7
VI. Rekomandimet.....	8

## Përmbledhja Ekzekutive

Autoritetet e Kosovës në mënyrë deklarative e kanë përcaktuar trashëgiminë kulturore si një ndër sektorët prioritarë. Një gjë e tillë sipas tyre rrjedh nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2018.<sup>1</sup> Mirëpo zhvillimet përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 dhe gjysmës së parë të vitit 2017 tregojnë se mbrojtja dhe menaxhimi i duhur i trashëgimisë kulturore në tërë Kosovën mbetet një sfidë mjaft serioze, e cila mund të adresohet me krijimin e një agjende shtetërore për trashëgiminë kulturore.

Përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 dhe gjysmës së parë të vitit 2017, autoritetet e Kosovës kanë dhënë shenja për një qasje më serioze në raport me trashëgiminë kulturore. Por këtë e kanë bërë vetëm pas presionit qytetar. Grupe aktive të qytetarëve dhe OSHC-të, në muajt e fundit, kanë dëshmuar një aktivizëm të shtuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në qytetet e tyre, duke nxitur kështu autoritetet shtetërore që të veprojnë dhe t'i korrigjojnë gabimet apo lëshimet në raport me projektet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.

Sikurse në vitin e kaluar incidentet e dëmtimit apo shkatërrimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar dhe kryesit e këtyre veprave nuk janë ndëshkuar. Pavarësisht nga masat që janë ndërmarrë nga autoritetet, degradimi sistematik i trashëgimisë, sidomos në

zonën historike të Prizrenit vazhdon edhe këtë vit që të paraqes rrezik për sigurinë publike. Por më në fund me fondet e MKRS-së në vitin 2017 janë iniciuar intervenimet emergjente në disa objekte të trashëgimisë kulturore në Prizren.

Pos riaktivizimit të komponentit të ndërhyrjeve emergjente në monumentet në rrezik, është miratuar Strategjia Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore dhe po ashtu është bërë aktivizimi i skemës së granteve të vogla. Mirëpo procesi për plotësim-ndryshimin e legjislacionit që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe liritë fetare ende nuk është përmbyllur. Madje sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme mos miratimi i projektligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe projektligjit për Liritë Fetare paraqesin arsytet se përse Kosova ende nuk ka aplikuar për anëtarësim në UNESCO.

Në anën tjetër rëndësia e planifikimit hapësinor si një disiplinë shumë sektoriale e cila koordinon dhe është e ndërvarur nga të gjitha strategjitë dhe programet kombëtare dhe lokale ende nuk po njihet si e tillë në nivel kombëtar. Një gjë e tillë ka reflektuar edhe në nivelin lokal, ku ka munguar vullneti politik për të prioritetizuar forcimin e këtij sektori duke krijuar kapacitete vitale që do të jenë në gjendje të operojnë në mënyrë efikase në sistemin e ri të planifikimit hapësinor.

Krahas kësaj edhe procesi i iniciuar për hartimin e Ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Kosovë nuk është përmbyllur ende, duke i lënë të pa trajtuara mbi 350 mijë ndërtime pa leje në Kosovë.

<sup>1</sup> "Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027", Qeveria e Kosovës - MKRS, 2016, linku: [http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip\\_strategjia\\_per\\_trashegimi.pdf](http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf), qasur me 1 shtator 2017

## Situata ekzistuese në trashëgiminë kulturore në Kosovë

Sipas përkufizimit të autoriteteve të Kosovës trashëgimia kulturore e Kosovës përfshin monumentet, lokalitetet, artefaktet dhe atributet jomateriale të krijuara nga të gjithë njerëzit që jetuan në Kosovë përgjatë shekujve.<sup>2</sup>

Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare sipas dispozitave të Kushtetutës, të cilat gjithashtu e obligojnë shtetin që ta promovojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve, derisa i njëjti akt krijon detyrime të veçanta për sigurimin e mbrojtjes efektive të të gjitha objekteve dhe monumenteve të rëndësishme kulturore dhe fetare për komunitetet.<sup>3</sup>

Krahas Kushtetutës, baza ligjore përbëhet nga ligjet në fuqi, si: Ligji për Trashëgimi Kulturore, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (përfshirë Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin për Hoçën e Madhe), Ligji për Fshatin Zym të Hasit; Ligji për Lirinë Fetare në Kosovë, Ligji mbi Eksproprijimin, Ligji i Ndërtimit, Ligji për Institucionet e Kulturës dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale; gjithashtu ligjet tjera si Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji për Arkivat, aktet nënligjore siç është ai mbi Komisionin për Monitorim dhe Zbatim (KMZ) përfshirë akte të tjera administrative të cilat sigurojnë mbrojtjen e veçantë të trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, si dhe provizionet e bashkëpunimit evropian dhe standardet ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore dhe praktikave më të

mira, duke përfshirë ato që promovojnë diversitetin dhe dialogun kulturor dhe fetar.<sup>4</sup>

Ndërsa rritja e buxhetit për MKRS-në sipas zyrtarëve të këtij dikasteri dëshmon përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që mes tjerash fushat e kulturës e trashëgimisë të mbesin ndër prioritetet e Qeverisë. Fusha e Trashëgimisë Kulturore për vitin 2017 ka një buxhet prej rreth pesë milionë euro për kategoritë: Ruajtja, Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore dhe Prezantimet dhe kërkimet për trashëgimi.<sup>5</sup>

Në mbledhjen e mbajtur me 30 dhjetor 2016, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027. Sipas Ministrisë të Kulturës kjo është strategjia e parë e Kosovës në këtë fushë që nga paslufta dhe miratimi i saj shënon moment të rëndësishëm për administrimin, konservimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Strategjia Kombëtare e trashëgimisë kulturore ka përcaktuar pesë objektiva themelore: 1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale, 2. Qasje e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm, 3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore, 4. Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe 5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Po aty

<sup>5</sup> "MKRS-ja me buxhet të rritur përreth 60%", njoftim nga MKRS, 27 dhjetor 2016, linku: <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,1434#.WavUgMZLeM8>, qasur me 31 gusht 2017

<sup>6</sup> "Qeveria e Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt", njoftim nga Kryeministria, 30 dhjetor 2016, linku: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,6462>, qasur me 1 shtator 2017

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Po aty

Krahas kësaj autoritetet e Kosovës gjatë kësaj periudhe kanë riaktivizuar komponentin e ndërhyrjeve emergjente në monumentet në rrezik, pastaj bashkë me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore është bërë edhe aktivizimi i skemës së granteve të vogla, ndërkohë që është iniciuar edhe nisma për Muzeun e Historisë së Natyrës.

Por procesi për plotësim-ndryshimin e legjislacionit që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe liritë fetare ende nuk është përmbyllur. Madje sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme mos miratimi i projektligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe projektligjit për Liritë Fetare paraqesin arsyet se përse Kosova ende nuk ka aplikuar për anëtarësim në UNESCO.<sup>7</sup> Qeveria e Kosovës vjet pat miratuar propozimin e MKRS-së për krijimin e Task Forcës për koordinimin e punës për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare që kanë lidhje të ngushta me UNESCO-në dhe organizata tjera relevante të kulturës dhe trashëgimisë, por që puna e saj nuk është shquar për kah transparenca para publikut.

Në raportin e muajit maj të Sekretarit Gjeneral të OKB-së për UNMIK-un thuhet se ka shqetësime rreth zbatimit jokonsistent të obligimeve ligjore nga ana e institucioneve të Kosovës në raport me trashëgiminë kulturore dhe fetare.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> "Kosova nuk ka aplikuar në UNESCO", kronikë e RTK-së, linku: <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=191273>, qasur me 2 shtator 2017

<sup>8</sup> "Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo", OKB, maj 2017, linku: <http://undocs.org/S/2017/387>, qasur me 3 shtator 2017

Ndërsa në raportin e muajit korrik të Sekretarit Gjeneral të OKB-së për UNMIK-un thuhet se Sekretari Gjeneral inkurajon ndërmarrjen e më shumë veprimeve për konsolidimin e sundimit të ligjit në Kosovë, edhe në raport me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<sup>9</sup> Në të njëjtin raport përmenden edhe shqetësimet e ngritura nga organizatat e shoqërisë civile rreth shkëljes së Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, që reflekton mangësitë e zbatimit të ligjit dhe neglizhencën e institucioneve lokale e qendrore.<sup>10</sup>

Ngjashëm sikurse në vitin e kaluar incidentet e dëmtimit apo shkatërrimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar dhe kryesit e këtyre veprave nuk janë ndëshkuar. Pavarësisht nga masat që janë ndërmarrë nga autoritetet, degradimi sistematik i trashëgimisë, sidomos në zonën historike të Prizrenit vazhdon edhe këtë vit që të paraqes rrezik për sigurinë publike. Megjithëkëtë me fondet e MKRS-së në vitin 2017 janë iniciuar intervenime emergjente në disa objekte të trashëgimisë kulturore në Prizren. Ndërsa Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit e krijuar në vitin 2014 për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka mbi një vit që nuk është funksionale dhe nuk ka mbajtur asnjë takim, derisa rezultatet e deritanishme të punës së saj janë inekzistente. Mbetet që autoritetet e Kosovës të intensifikojnë politikat dhe veprimet e tyre akoma për mbrojtjen dhe menaxhimin e mirëfilltë të trashëgimisë kulturore në nivel vendi.

Një kontribut i domosdoshëm në këtë drejtim do të ishte edhe priorizimi dhe shtimi i

<sup>9</sup> "Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo", OKB, korrik 2017, linku:

<http://undocs.org/S/2017/640>, qasur me 3 shtator 2017

<sup>10</sup> Po aty

efikasitetit të autoriteteve përgjegjëse për inventarizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në gjithë territorin e Kosovës, që paraqet një masë të pashmangshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Kësisoj me regjistrimin dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore do të sigurohej edhe baza për vlerësimin e tyre nëse gëzojnë mbrojtje ligjore. Për më shumë do të ishte ndihmesë për evitimin e rasteve të rrënimt të shtëpive të vjetra dhe objekteve tjera publike, sikur shembulli në Pejë, kur me autorizim të autoriteteve lokale është rrënuar objekti gati 100 vjet i vjetër i shkollës së parë të mesme të arteve aplikative në Kosovë.<sup>11</sup>

### Qendra Historike e Prizrenit me statistika të dhimbshme

Mungesa e sundimit të ligjit dhe injoranca totale e autoriteteve komunale dhe institucioneve përkatëse për një dekadë e ka kthyer qendrën historike të Prizrenit në një qendër të kaosit. Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore kanë pësuar dëmtim e shkatërrim, duke u zëvendësuar me hotele e parkingje ilegale. Konstatimet e mësipërme mbështeten në një hulumtim të EC-it (që do të publikohet së shpejti).

Bazuar në këtë hulumtim del se afër gjysma e monumenteve brenda qendrës historike janë në rrezik për shkatërrim. Nga 121 monumente të listuara brenda Qendrës Historike, 31 sosh janë rrënuar. Ndërsa nga 382 shtëpitë tradicionale

që ishin në vitin 2006 brenda kësaj zone, sot kanë mbetur vetëm 155, apo 227 sosh janë rrënuar. Ndërsa 64 shtëpi tradicionale janë në rrezik. Në këtë zonë operojnë 34 vendparkime, prej tyre 20 të paregjistruar, dhe 25 shtëpi tradicionale janë rrënuar për të krijuar hapësirë për vendparkime.

Siç u tha edhe më lartë, Task Forca e themeluar në vitin 2014 për Qendrën Historike të Prizrenit nuk ka prodhuar asnjë rezultat deri më sot. Ndërkohë trendi i degradimit nuk po ndalet, ku vetëm gjatë 3 viteve të fundit janë humbur dhjetëra monumente. Një tjetër monument në kuadër të kompleksit të Kishës Katolike pas disa rasteve të zjarrit, në vitin 2017 u bë rrafsh me tokën, para syve të autoriteteve.

Në anën tjetër vetëm 3.3% e zonës historike është e gjelbëruar, dhe atë me vetëm 191 drunj. Pothuajse asnjë ndërtesë publike ose monument brenda zonës historike nuk ofron qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuar.

Prizreni ka një diversitet të rrallë kulturor, dhe e ka një potencial të jashtëzakonshëm për të konkurruar edhe në trashëgiminë botërore. Por, fal mospërkujdesjes institucionale dhe shkatërrimit sistematik sot ka degraduar në një qendër të uzurpatorëve dhe ndërtimeve ilegale.

Shkatërrimi sistematik i trashëgimisë kulturore në qendrën historike të Prizrenit ka kaluar në një trend, që në vitin 2016 ia morri jetën një fëmije të pafajshëm. Autoritetet përgjegjëse, si rezultat i mosveprimit të tyre, janë përgjegjëse për këtë tragjedi. Në të njëjtën kohë, ky rast dëshmon pafuqinë e sistemit të drejtësisë për të vendosur drejtësi. Drejtësia do të duhej të ishte garant që raste të tilla të mos përsëriten. Sundimi i ligjit duhet të jetë garant në mbrojtje

<sup>11</sup> "Artistët e opozita kritikojnë ashpër rrënimin e objektit të shkollës së parë të muzikës në Pejë", Koha.net, 9 shtator 2017, linku: <http://www.koha.net/kosove/43112/artistet-e-opozita-kritikojne-ashper-rrenimin-e-objektit-te-shkolles-se-pare-te-muzikes-ne-peje/>, qasur me 10 shtator 2017

të jetës së njerëzve, trashëgimisë, diversitetit dhe vlerave kulturore të Prizrenit.

EC dëshiron të sjellë në kujtesë se gjatë viteve të fundit nga Prokuroria janë iniciuar disa hetime lidhur me shkatërrimin e objekteve në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike, sikurse që ka pas edhe raste të aktakuzave të ngritura, por që nuk janë përmbyllur me aktgjykime dënuese nga Gjykata. Edhe në ato pak raste të përfundimit në gjykatë, aktakuzat për veprat penale brenda Qendrës Historike kanë qenë tejet shterpe, duke i sfiduar edhe gjykatësit në marrjen e vendimeve dënuese.<sup>12</sup> Asnjë vendim dënues nga gjykata për dëmtimin e trashëgimisë kulturore nuk ka, ani pse ka raste të konsiderueshme që janë raportuar.

Në anën tjetër hartimi i Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit si dhe intervenimi nga ana e Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në restaurimin dhe konservimin e disa objekteve të mbrojtura janë hapat pozitivë që janë ndërmarrë nga autoritetet. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti aktivitetet e trashëgimisë kulturore kanë ndikuar në arritjen e marrëveshjes mes autoriteteve lokale e qendrore, shoqërisë civile dhe donatorëve ndërkombëtarë për revitalizimin e rrugës “Marin Barleti” në Qendrën Historike të Prizrenit.

### Sfidat në Planifikimin Hapësinor

Rëndësia e planifikimit hapësinor si një disiplinë shumë sektoriale e cila koordinon dhe është e

ndërvarur nga të gjitha strategjitë dhe programet kombëtare dhe lokale nuk është njohur si e tillë në nivel kombëtar. Kjo reflektohet edhe në nivelin lokal, ku ka munguar vullneti politik për të prioritetizuar forcimin e këtij sektori duke krijuar kapacitete vitale që do të jenë në gjendje të operojnë në mënyrë efikase në sistemin e ri të planifikimit hapësinor. Në Kosovë, niveli qendror ka obligim të krijojë kushte për planifikim hapësinor efektiv për nivelin lokal, si përmes hartimit të kornizës ligjore ashtu edhe përmes asistencës për të ndërtuar kapacitetin e nivelit lokal për të marrë përsipër detyrat e planifikimit hapësinor të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor (LPH). Kjo nënkupton një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet MMPH dhe komunave si në aspekt të zbatimit të politikave ashtu edhe në ndërtim të kapaciteteve. MMPH duhet të ndihmojë komunat në lehtësimin e komunikimit me ministrinë dhe institucionet tjera në sigurimin e të dhënave dhe harmonizimin e planeve me politikat nacionale sektoriale.<sup>13</sup>

Kapacitetet njerëzore, përmirësimi i organizimit institucional dhe politikave të buxhetimit janë faktorët kyç për funksionimin efikas të Autoriteteve komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor. Këto çështje janë të një rëndësie të veçantë meqenëse zgjidhja e tyre shpesh është më e vështirë se sa çështjet teknike (sigurimi i pajisjeve dhe programeve të teknologjisë informative) që po ashtu janë të domosdoshme.

<sup>12</sup> “Drejtësi të plotë për Xhenetën”, Opinion nga EC Ma Ndryshe, gusht 2017, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/Opinion\\_D\\_rejtesi\\_te\\_plote\\_per\\_Xheneten.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/Opinion_D_rejtesi_te_plote_per_Xheneten.pdf), qasur me 1 shtator 2017

<sup>13</sup> “Sfidat e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në Komuna”, Analizë, EC Ma Ndryshe, maj 2016, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/160530170\\_335\\_EC\\_PRO\\_Analiza\\_SHQ.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/160530170_335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf), qasur me 3 shtator 2017

Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor nuk janë të përgatitura sa duhet për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate kërkesave që janë vënë përpara me LPH. Ligji i ri sado i mirë mund të jetë, nuk mund ta përmirësojë gjendjen e vështirë në planifikim hapësinor, nëse nuk ka kapacitete njerëzore dhe mekanizma të duhur institucional për zbatimin e tij.<sup>14</sup>

Kompletimi sa më parë i kornizës ligjore është parakusht për zbatimin e dispozitave dhe obligimeve që rrjedhin nga LPH, në veçanti për komunat. Është shumë e nevojshme që stafi profesional i komunave të jetë i përfshirë në takimet punuese me fokus grupe për hartimin e akteve nënligjore të mbetura.

MMPH duhet t'ju ofrojë mbështetje ligjore komunave në interpretimin e LPH dhe ligjeve tjera të ndërlidhura. Kontradiktat ligjore të LPH dhe ligjeve ndërlidhëse duhet të analizohen dhe jipen udhëzime të qarta për tejkalimin e tyre. LPH është ambicioz në raport me përmbushjen e kërkesave ligjore nga ana e komunave dhe kapaciteteve të tyre. Reformat ligjore nuk mund të ndryshojnë gjendjen aktuale në terren nëse nuk përcillen me aftësim adekuat të zyrtarëve të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor. Përvoja e mëhershme ka dëshmuar se është e nevojshme ngritja në vazhdimësi e këtyre kapaciteteve. Komunat kanë nevojë për këshilla, asistencë teknike (mbështetje profesionale) dhe trajnime të specializuara në këtë fushë.<sup>15</sup>

Sfida të shumta ka edhe në aspektin e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor

legjislacioni parasheh organizimin e diskutimeve publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes publike për definimin e vizionit, objektivave, prioriteteve strategjike dhe çështjeve të tjera. Kërkesa minimale për pjesëmarrjen e publikut është që të sigurojë të paktën një diskutim publik për çdo fazë të procesit të planifikimit. Por autoritetet lokale e qendrore të planifikimit nuk i zbatojnë këto parime në të gjitha rastet, gjë që ka rezultuar me shprehjen e pakënaqësive të banorëve të Zhupës (Prizren) dhe Gorës (Dragash) lidhur me planet për ndërtimin e hidrocentraleve në këto treva.

Ndërsa procesi i iniciuar për hartimin e Ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Kosovë nuk është përmbyllur ende. Kësisoj mbi 350 mijë ndërtime pa leje në nivel të Kosovës mbeten akoma të pa trajtuara.

### Aktivizmi qytetar dhe trashëgimia kulturore

Grupe të qytetarëve dhe organizata të shoqërisë civile, gjatë muajve të fundit, në disa qytete të Kosovës kanë dhënë dëshmi konkrete të aktivizmit në mbrojtjen e qyteteve përkatësisht trashëgimisë kulturore të tyre, të cilat reague kanë nxitur autoritetet shtetërore që të ndërmarrin veprime korigjuese lidhur me këto raste.

Në Vushtrri, pas reagimit të aktivistëve lokalë, Ministria e Kulturës ka anuluar një kontratë të dyshimtë, të nënshkruar në mënyrë jotransparente me një kompani private për menaxhimin e Kalasë së Qytetit.

Në një rast të ngjashëm, pak ditë para këtij rasti, organizatat e kulturës në Pejë kanë qenë shumë të zëshme duke ndikuar në kthimin e

<sup>14</sup> Po aty

<sup>15</sup> Po aty

kalldrëmit në një pjesë të sheshit të qytetit, përkundër faktit se autoritetet qendrore dhe lokale ishin treguar neglizhente ndaj gjetjes së gurëve gjatë kryerjes së punimeve.

Në Prizren, aktivistët e trashëgimisë kulturore përfundimisht kanë ndikuar në arritjen e marrëveshjes mes autoriteteve lokale e qendrore, shoqërisë civile dhe donatorëve ndërkombëtarë për revitalizimin e rrugës “Marin Barleti” në Qendrën Historike të Prizrenit, ku vitin e kaluar si pasojë ë shembjes së një shtëpie të vjetër kishte humbur jetën një tre vjeçare.

Ndërsa në Mitrovicë, aktivistët e shoqërisë civile dhe grupe të qytetarëve ka kohë që janë mobilizuar në mbrojtje të shtëpisë së Xhafer Devës dhe shtëpisë së ish-Armatës, ndërsa në të dyja rastet autoritetet e shtetit kanë treguar gatishmëri dhe priten veprime të shpejta në drejtim të mbrojtjes së këtyre objekteve.

Në të gjitha këto raste, aktivizmi qytetar, që në disa qytete është veprim konsistent i viteve të fundit, ka arritur të aktivizojë edhe mekanizmat e shtetit që e kanë në mandat mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore.

EC konsideron se këto janë shkëndijat e para të shpresës për qasje serioze të shtetit në raport me trashëgiminë kulturore. Megjithatë, për shkak të degradimit sistematik, trajtimi i pasojave është ndërmarrje që kërkon angazhim shumë të madh dhe afatgjatë nga autoritetet e shtetit.

## Rekomandimet

EC beson në mundësinë për të vendosur trashëgiminë lart në prioritetet e shtetit. Për këtë arsye, i bën thirrje autoriteteve të shtetit, në radhë të parë Qeverisë së Kosovës, që të hartojë urgjentisht një agjendë shtetërore për trashëgiminë kulturore, e cila do të nxiste mobilizim të të gjitha kapaciteteve shtetërore dhe shoqërore.

Pjesë e kësaj agjende shtetërore për trashëgiminë kulturore duhet të jenë së paku këto veprime ose prioritetet:

-Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për të gjitha asetet e trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të shtetit;

-Funksionalizimi i plotë i mbrojtjes së përhershme ligjore të aseteve të trashëgimisë kulturore, ashtu që t'i jepet fund praktikës së mbrojtjes së përkohshme;

-Qeveria përkatësisht MKRS-ja duhet të jetë shumë më e koordinuar me autoritetet e nivelit lokal (komunat) rreth mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të aseteve të trashëgimisë kulturore;

-MKRS të krijojë mekanizma konsultativ me shoqërinë civile në fushën e trashëgimisë kulturore;

-MKRS të fillojë një dialog të hapur dhe konstruktiv me pronarët privat të aseteve të trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme në mënyrë që të mbrohet trashëgimia kulturore dhe të përkrahen pronarët në fjalë;

-Prioritizimi dhe shtimi i efikasitetit të autoriteteve përgjegjëse për inventarizimin e



objekteve të trashëgimisë kulturore në gjithë territorin e Kosovës;

-Zbatimi i plotë i ligjit për rastet e veprës penale 'dëmtim i monumenteve' (përfshirë këtu edhe rolin më aktiv të organeve të drejtësisë, të cilat duhet të rrisin nivelin e përgjegjësisë në këtë drejtim);

-Angazhim për një aplikim të denjë për anëtarësim në UNESCO dhe me transparencë për procesin;

-Restaurimi i pjesës së mbetur të kishave ortodokse të dëmtuara në vitin 2004;

-Miratimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit të lokalitetit arkeologjik 'Ulpiana';

-Trajtimi profesional dhe me prioritet i lokaliteteve arkeologjike të zbuluara rishtazi dhe

-Miratimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për Qendrat Historike të Kosovës.